

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

ERIO LA AGALLIU

HEROI INTELEKTUAL I KOKONËS - NJË PRODUKT I IMPORTUAR NGA PERËNDIMI APO I FUNDIMI I ROMANTIKËVE SHQIPTARË?!

*(Karakteri i heroit në tregimet “Lush Bardhi”, “Këpuca e zonjës”
dhe në romanin “Me valët e jetës”)*

Heroi i Vedat Kokonës është sivëllami i heronjve intelektualë, të epokës: Dr. Gjilpëra i Konicës, Hilush Vilza e Lec Gurmolla i Koliqit, Nushi i Migjenit, Gjon Zaveri i Spasses të cilët, edhe pse në sinkron, me heronjtë e letërsive të tjera evropiane, sjellin me botëkuptimin e tyre, një qasje të ndryshme në raport me shoqërinë shqiptare të kohës. Në letërsinë shqipe ky hero vjen si produkt i universiteteve perëndimore qofshin ato në Itali, Francë apo Austri. Në Tiranën e asaj kohe (por edhe në qytete të tjera të mëdha si Shkodra e Korça) këta të rinj, të sapodiplomuar, përbëjnë trendin më përparimtar të epokës duke shpalosur, në shoqërinë shqiptare, një frymë evropianizimi të munguar e të shumëpritur, njëkohësisht. Është e qartë se krijuesit, në këtë epokë, projektojnë, te heronjtë intelektualë, unin e tyre kompleks, me dëshirat dhe dilemat që mbartin, me një lloj tëhuajsimi në raport me mjedisin që gjejnë këtu por, mbi të gjitha, me raportin kontrovers që krijojnë me bashkëkombasit, kur kthehen në atdhe.

Heroi intelektual i Vedat Kokonës duket se i përmbledh gjithë çka thamë më lart. Me një prirje dendizmi të spikatur, ky intelektual endet rrugëve të Tiranës si një njeri i tepërt të cilin nuk e lidh asgjë me mjedisin që gjen këtu. Ai kujton me mall rrugicat e Parisit, aventurat rinore, poetët e mëdhenj vargjet e të cilëve i pëshpërit në heshtje. Parisi u ka ofruar heronjve tanë një prirje boheme, prej njeriu soditës i cili përjeton, më fort sesa vepron e flet. Në karakterin e këtij njeriu, Franca ka mprehur ndjeshmërinë ndaj të bukurës por edhe ndaj vuajtjes, ka bërë të provojë shijen e njelmët të zhgënjimit në aventura dashurie. Parisi i fillimshëkullit XX, ka formësuar tek djaloshi i ri një lloj dhimbjeje të padukshme, të cilën ai do ta vendosë si mburojë përpara çdo situatë të mëpastajme, me kthimin në atdhe. Nga Parisi, ky intelektual (i cili portetizohet, si mësues dhe poet) huazon doza të forta, snobizmi, manierizma, të pakuptimta në dukje, e pse jo edhe indiferencën si bashkëshoqëruese të përhershme. Të paktën në sytë e bashkëkombasve të tij lexohet si i tillë. Edhe pse, në marrëdhënie me ta, ai shfaqet korrekt dhe përpiqet të jetë sa më mirëkuptues. Heroi ruan thellë, brenda vetes, kujtimet e bukura të rinisë në Paris: *“fytyra mikeshash që kishte njohur dikur në hijet e kopshteve, në shkëlqimin e veluar të dancingeve, në frontet e amfiteatrit, leshverdha, të zeshkëta, të stolisura, me një buzëqeshje të ëmbël në fytyrë. E çdo fytyrë ishte për të një libër i vogël ku këndonte me mendje historinë e një zemre të lënduar.”*¹

¹ V. Kokona, *Lutja e fundit*, Botimet Kokona, Tiranë, 2008, f. 143.

Është malli, ndoshta, për Parisin, i identifikuar me vargjet e Bodlerit, i cili e shoqëron heroin e tregimit **“Këpuca e zonjës”** (1940) - Një tregim me temë nga jeta qytetare, i cili trajton një temë intime me nëntekst të fuqishëm erotik. Fabula e tregimit është shumë e thjeshtë dhe konflikti kalon në heshtje nëpërmjet përjetimeve të vetë heroit. Një poet i ri, i ftuar nga miku i tij për një fundjavë në plazh. Një ndjesi e pazakontë lind mes Lushit (heroit tonë) dhe nuses lozonjare të mikut të tij. (Psikanaliza do të na vinte në ndihmë për të analizuar situatën dhe reagimin e personazheve në këtë rrëfim të thjeshtë.) Përgjithësisht, edhe në këtë tregim, i lihet vend përshkrimit të mërzi, boshësisë së ditëve të heroit dhe ka, fare pak veprim, ose, më saktë, veprimi është i ngjeshur në disa rreshta. Pikërisht, për figurën e heroit, studiuesi Hasan Mekuli shprehet: *“Kemi të bëjmë me një produkt libreshk, i cili jo rastësisht na paraqitet si tip shoqëror, sepse edhe ishte “karakter” interesant dhe jo i rrallë i një kohe e hapësire plot absurde, i përkëdhelur nga komoditeti, i llastuar si intelektual, e megjithatë i zbritur moralisht, i lodhur, i humbur.”*²

Me gjithë sa thamë më lart, ne vërtet bindemi se figura e intelektualit, në prozën e Kokonës, vjen si produkt i importuar nga jashtë. Distanca kohore dhe fizike larg mjedisit të vet, ka formësuar një karakter të çuditshëm dhe të pakuptueshëm për mjedisin shqiptar. E megjithatë, ndryshimi ndonjëherë mund të jetë vetëm në dukje. Në thellësinë e vet, ky hero kërkon të injektojë, të bashkëatdhetarët e vet, strukturat mendore të perëndimit. Personazhi që i mbart këto cilësi është pikërisht Lush Bardhi i cili e nis rrugëtimin e jetës si një bir fshatari, për të përfunduar, më pas, me sukses, studimet në Francë (I shkruar në vitin 1939 tregimi nuk ka sesi të mos na ravijëzojë ngjashmëritë mes portretit të heroit e, të krijuesit, Kokona.). Me kthimin në atdhe, para Lushit hapen dyer dhe mundësi të reja. Ai mund të qëndrojë në kryeqytet, të realizojë vetveten në profesionin e tij, por Lushi zgjedh, pa hezitim, kthimin në vendlindje në fshat. Në një fragment ai shprehet: *“Ja ku janë motrat dhe vëllezërit e tu të vërtetë, me të cilët do ta kalosh jetën tënde. Mundohu t’i bësh të lumtur që të jesh i lumtur edhe vetë. Dielli duhet të lindë më parë prapa malit dhe pastaj ta ndriçojë fushën. Ti je fusha edhe ata mali. Së andejmi do të kullojë drita e vërtetë.”*³

Pikërisht në këtë fshat, të pashkelur nga qytetërimi, Lushi gjen dashurinë e tij të vërtetë dhe krijon familjen e ëndërruar. Lush Bardhi martohet dhe jeton në fshat, si mësuesi që do të frymëzojë brezat. Duket qartë, në këtë tregim, një mbyllje moralizuese ose një konfigurim ideal, për devotshmërinë dhe misionin e intelektualit në shoqëri: *“Shkoi shtëpi më shtëpi dhe u foli me zë të butë gjithë fshatarëve: të gjithë duhej t’i shkruanin fëmijët në shkollë, se vetëm kjo do t’i nxirrte në jetën e vërtetë; atdheu i tyre kishte nevojë për djem të mësuar, për djem*

² V. Kokona, *Yje të këputur*, Rilindja, Prishtinë, 1986 (me pasthënie nga Hasan Mekuli), f. 192.

³ V. Kokona, *Lutja e fundit*, Botimet Kokona, Tiranë, 2008, f. 153.

Heroi intelektual i Kokonës – një produkt i importuar nga perëndimi...

*të rritur me këndim dhe me ndjenja të kulluara se këta ishin shpresa e bukur e Shqipërisë.*⁴

Të dyja këto tregime janë shkruar në vitet 1939-1940 dhe figura e intelektualit përpiqet të ekuilibrojë brenda vetes kulturën e fituar në Perëndim dhe vënien e saj në shërbim të zhvillimit shoqëror shqiptar (Miti i qytetërimit - do ta quante në një analizë studimore prof. dr. Shaban Sinani, këtë situatë.).

Paksa më ndryshe qëndron puna me heroin intelektual të romanit Ismail Kamberin. Sipas kujtimeve të vetë Kokonës, “Me valët e jetës” i ka fillimet e veta në vitin 1958. Shkrimi i tij ka zgjatur plot dy vjet dhe romani botohet në vitin 1961. Duke pasur parasysh këtu raportet me regjimin, në autobiografinë e tij, Kokona kujton “*Këtë roman nuk e kisha filluar ‘nga halli’, [...] e kisha filluar për qejfin tim dhe me bindjen se ai nuk do të botohej kurrë për arsyen e thjeshtë se protagonistin nuk do të ishte komunist, siç e kërkonte metoda e realizmit socialist. Dhe thashë se aty do të përshkruaja një pjesë të biografisë sime, ashtu siç do ta kisha shkruar atëherë kur fjalët, që buronin nga zemra, dilnin të lira dhe fluturonin mbi krahët e frymëzimit. [...] Isha nisur me mendimin që të bëja një ‘triologji’, si ‘Rruga e mundimeve’ të Aleksei Tolstoit*”.⁵

Romani “**Me valët e jetës**” hapet me skenën e kthimit të Ismail Kamberit në atdhe, pas tri viteve të studimit në Francë. Dehja nga ëndrrat rinore e pikëllimi për ndarjen, me Klotildën e bukur, bëjnë që heroit të ndiejë në shpirt një zbrazëturë të frikshme dhe një ankth të pashpjegueshëm për të panjohurën, në atdhe. Në faqet e para të romanit lexojmë: “*Si në një film kinematografik e fantastik i parakaluan me të shpejtë përpara syve të mendjes çastet e ëmbla të asaj jete të bukur që kishte kaluar larg atdheut.*” Vetëdija për një jetë e një realitet të ri, tenton të zgjohet brenda shpirtit të trazuar të heroit. Nga Franca ai sjell pasionin për letërsinë dhe kulturën e fituar. “*Malet e larta të Shqipërisë, që kalëronin turbull atje thellë në horizont, i sollën ndër mend vargjet e bukura të Naimit dhe atë çast, dashuria dhe malli i atdheut e rrëmbyen përnjëherësh nga gjiri i një jete plot me argëtime e dëfrime levarashe dhe e sollën në jetën e vërtetë, ku do të rronte këtej e tutje.*”⁶

Kjo hyrje, në roman, shërben, si parantezë, për të zbuluar karakterin prej të huaji të Ismailit në thuajse të gjitha ngjarjet që do të vijojnë më pas. Me ardhjen në atdhe, vjen martesë, detyrimet familjare, lindja e fëmijëve, etapa të cilat heroit i kalon me korrektesë e qetësi, në dukje, sikurse e kërkon tradita dhe respekti ndaj prindërve. Për Ismail Kamberin, martesë nuk është veçse një institucion rregullave të të cilit ai duhet t’i bindet me devotshmëri, edhe pse në heshtje krahason duart e nxira nga punët të gruas së vet me gishtërinjtë delikatë të zonjushave që pat njohur. Mbrapa këtij modeli shembullor, nuk është e vështirë të dallojmë, në thellësi, një shpirt të trazuar, i cili merr përsipër të na rrëfejë, më fort, për ato çka sheh përreth, drama të vogla, personale e familjare, të cilat ndërthuren me dramën

⁴ Po aty, f. 154.

⁵ V. Kokona, *Endur në tisin e kohës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2006, f. 242-243.

⁶ V. Kokona, *Me valët e jetës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2003, f. 14-15.

e madhe shoqërore. Gjatë gjithë romanit duket se heroi ynë merr përsipër këtë detyrë: të bëhet dëshmitar i një epoke plot ndryshime, si një soditës pasiv i saj.

Në roman, tablotë ndjekin njëra - tjetrën, në mënyrë të shpejtë, si për të na dhënë edhe njëherë çoroditjen shoqërore, shqiptare, të atyre viteve. Nga njëra skenë në tjetrën ndryshojnë dialektet, ngjyrat, karakteret, mjediset dhe në këtë rrugëtim heroi ynë vijon të endet qetësisht me kostumin e tij karakteristik prej intelektual, e me indiferencën (për të cilën shpesh e qorton veten - [autocensura e realizmit socialist]) e një njeriu i cili nuk ndihet mirë as me gruan në shtëpi, as me të rinjtë revolucionarë, as me shokët e kafenesë... Kjo përmasë e të qenit ndryshe, ravijëzohet në një konflikt shpirtëror të përhershëm, mes dukjes dhe thelbit, te Ismail Kamberi. Edhe si profesor në gjimnaz, ai është në gjendje të ndajë patriotizmin e Rilindjes sonë Kombëtare (të cilin e sheh të mbrujtur më së miri në vargjet e Naimit, P. Vasës, apo Çajupit) me xhentesën prej intelektual frankofil që e ushqen pareshtur nga leximet e autorëve më të mëdhenj francezë. Ky dyzim realizohet, në roman, edhe në marrëdhëniet që krijon heroi me personazhet e tjera të veprës: Ai e admiron në fshehtësi karakterin e Telit dhe shokëve revolucionarë të Korçës; pëlqen faktin që motra e tij Manushaqja angazhohet në lëvizjen e vajzave të institutit "Nana Mbretëshë"; përbuz figurat e tregtarëve të cilët e shohin pushtimin fashist si mënyrën, më të mirë të mundshme, për t'u pasuruar; e, megjithatë, Ismail Kamberi nuk ka fuqinë ose, më mirë të themi, nuk ka as dëshirën më të vogël për t'u bërë pjesë e këtyre grupimeve. Në përballje me një prift katolik, pyetjes së këtij të fundit nëse është nga ata "*qi nuk e kanë dishirue dhe as që e dëshirojnë bashkimin e Shqipnisë me Italinë*", Ismaili i përgjigjet thjesht: "*Unë jam një nga ata që janë shqiptarë dhe që duan të mbeten shqiptarë*".⁷ Ky personazh nuk parapëlqen të rreshtohet në asnjë nga grupimet politike - shoqërore të epokës, sikurse tri kolegët e tij në vepër: Reshat Delvina si proitalian, Vasil Panariti si progjerman dhe Kujtim Frashëri i lidhur me lëvizjen komuniste. Diskutimet mes tyre, Ismaili i dëgjon me qetësinë e një gazetari që informon mbi atë çka ndodh, pa qenë i përfshirë.

Vetëdija qytetare, brenda tij, funksionon edhe pa qenë, e burgosur, brenda një ideologjie të caktuar. Gjatë ditëve të pushtimit fashist, në kufijtë mes cinizmit dhe dhimbjes, heroi ynë shprehet: "*Ku ishin ëndrrat e bukura të kohës së djalërisë? Ja, edhe atdheu tani nuk ishte më, veçse një shprehje gjeografike në hartë, një vend që figuronte atje, në ngjyrën e tokës italiane. Nuk kishte më atdhe, nuk kishte më Shqipëri. Gjithë kjo nuk ishte veçse një komedi e madhe me një fund të hidhur*".⁸ Edhe pse i respektuar e autoritar para shoqërisë, nuk është vështirë të dallohet sesi e paragjykojnë disa nga familjarët e tij, me përbuzje, si *një njeri që rronte me ëndrra*. Si mësues, Ismail Kamberi sheh përditë nxënës të cilët braktisin shkollën për t'u bërë pjesë e lëvizjes antifashiste. Dhe ai mendon: "*Këto vende të zbrazëta ishin për Ismailin si sy të çuditshëm në ndërgjegje*".⁹ Kështu përthyhen, brenda

⁷ Po aty, f. 495.

⁸ Po aty, f. 375.

⁹ Po aty, f. 441.

Heroi intelektual i Kokonës – një produkt i importuar nga perëndimi...

tij, dhimbja për atdheun me hezitimin për t'u bërë ithtar i ideologjisë bolshevike. Ismail Kamberi nuk bëhet, kurrë, pjesë aktive e kësaj lëvizjeje. Por, nga ana tjetër, ai e braktis, pa hezitim, punën, në gjimnaz, kur drejtori italian u kërkon profesorëve të denoncojnë nxënësit e tyre, të lidhur me komunistët.

Në lidhje me mënyrën sesi reagon ky personazh, përballë dhunës e vdekjes, tri janë skenat domethënëse në roman: a) kapitullimi i Italisë fashiste na shfaq portretin tragjik të një ushtari italian, i cili detyrohet të shesë gjithçka për të mbijetuar; b) dita e Çlirimit të Tiranës na sjell, para syve, trupin e përgjakur të një gjermani, vrarë, anës rrugës; c) shpërthimi i fundit, i bombave, në kryeqytet i merr jetën një fëmije të vogël duke luajtur, në oborrin para shtëpisë.

Pasazhi i fundit në roman i cili i referohet figurës së heroit tonë, vijon si më poshtë: *"Ismaili e pa gruan tek ecte si e ngrirë, me djalin në duar, të cilit i vareshin koka, këmbët dhe krahë që i kishte mbetur. Rrezet e diellit, që nuk donin t'ia dinin për pikëllimin e nënës, luanin me kaçurrelat e verdha të kalamanit, që ishin stërpikur me gjak"*.¹⁰ Sikurse shihet, fundi i luftës nuk ka asgjë madhështore në sytë e tij. Madje në këto rrethana, as fitorja e shumëpritur nuk duket të jetë aq e lavdishme, sa e shpresojnë të rinjtë revolucionarë si Teli e Manushaqja. Pamja e një fëmije të vdekur, në krahët e nënës së vet, është më shumë sesa tragjike dhe nuk i përshtatet, aspak, mbylljes heroike të luftës partizane.

A mund të konsiderohet, ky hero intelektual, një karakter i plotë i letërsisë së realizmit socialist?

Në fakt ne mund të pohojmë, pa frikë, se Ismail Kamberi është një hero i sforcuar i realizmit socialist. Është një hero pa karakter luftarak, me një ngërç të madh në mënyrën sesi merr pjesë në përmbysjet shoqërore, të viteve 1934-1944, të cilat bëhen temë qendrore në letërsinë shqiptare të viteve '50-'60. Në të kundërt të këtij modeli soc-realist, intelektual i Kokonës, është gjithmonë një hero i cili tkurret në heshtjen e mosreagimit të tij dhe sjell, në skenë, drama të karaktereve tjera të cilat mbartin forcën që i mungon heroit tonë. Kjo është mënyra e tij e reagimit, përballë dhunës e të keqes si forma asgjësuese të qenies njerëzore. Kështu, ne mund të pohojmë se Ismail Kamberi mbetet anemik në vetëdijen klasore, ose se, atij, mund t'i përshtatet, më së miri, shprehja që përdor dikush për Dr. Zhivagon në romanin me të njëjtin titull të Pasternakut: *"Juri e ka të atrofizuar damarin që ushqen vetëdijen shoqërore dhe kjo nuk mund t'i falet një mjeku të shkolluar"* (citim nga Dr. Zhivago). Por që, përsëri, sikurse dr. Zhivago ai beson në vlerat universale të shpirtit njerëzor: dashuria, atdheu, liria.

Heroi intelektual i Kokonës mbetet një prurje origjinale në letërsinë shqipe. Një letërsi e cila, në përgjithësi, është konceptuar, shpesh, si letërsi e karaktereve heroike. Heroi i Kokonës nuk e shfaq një përmasë të tillë luftarake. Ndoshta mund të themi se ai ngjan, më tepër sesa duhet, me krijuesin e tij. Vetë Kokona, shkruan në kujtime: *"Trim s'kam qenë kurrë [...] por edhe mpleksjet me qeverinë s'më kanë pëlqyer kurrë. [...] dhe roli i heroit s'më ka ngashëryer kurrë."*¹¹

¹⁰ Po aty, f. 556.

¹¹ V. Kokona, *Endur në tisin e kohës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2006, f. 171.

Përtej çdo keqkuptimi të mundshëm, një thënie kaq e sinqertë na shtyn të besojmë për karakterin po kaq të sinqertë të personazheve të tij. Këta heronj, janë produkt i drejtpërdrejtë i formimit të tyre, intelektual, në Perëndim. Këta janë intelektualët, që i duhen vendit, për të cilët bënte thirrje Branko Merxhani, kur pohonte se: *“Jemi dishepuj të një brezi që mundohet të dalë nga errësira në dritë” (citim i Gëtes)*¹². I etiketuar shpesh si “njeri i tepërt”, si “intelektual i llastuar” apo si “njeri pa vetëdije revolucionare” ky personazh është i pranishëm në çdo epokë transformimesh të mëdha shoqërore, me potencialin e tij shpirtëror e mendor. Perëndimi u shërben atyre si prag për ndërgjegjësimin e qenies, për ta shfrytëzuar këtë potencial këtu në Shqipëri.

Mësuesi Lush Bardhi në tregimin me të njëjtin titull, Lushi në tregimin **“Këpuca e zonjës”** si dhe Ismail Kamberi në romanin **“Me valët e jetës”** na ofrojnë figurën e idealistit të çdo epoke, të cilët vuajnë dramën e moskuptimit në një shoqëri të paemancipuar, të vrazhdë, ndonjëherë edhe të dhunshme dhe që mbeten, shpesh, spektatorë periferikë të skenës shoqërore. Kjo ndodh sepse heronjve të Kokonës nuk u pëlqen protagonizmi, nuk kërkojnë breroren e lavdisë, ndër beteja.

A duhet t'i fajësojmë për këtë?! Absolutisht jo. Ata mbeten, deri në fund, dëshmitarë të shpirtit të lirë njerëzor, të papërlyer nga çfarëdolloj ideologjish të mbrapshta, të cilat i njohu bota, me shumicë, gjatë shekullit XX. Ata i rezistojnë çdo kohe, si për të na vërtetuar se kemi nevojë për dijen, kulturën, e humanizmin që rrezatojnë...

BIBLIOGRAFI

- Letërsia shqiptare dhe realizmi socialist*, Studime Albanologjike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2010/2.
 N. Kulla, A. Plasari, *Branko Merxhani - vepra*, Plejad, Tiranë, 2003.
 V. Kokona, *Endur me tisin e kohës* Botimet Kokona, Tiranë, 2006.
 V. Kokona, *Me valët e jetës*, Botimet Kokona, Tiranë, 2003.
 V. Kokona, *Quo vadis letërsi shqipe*, Botimet Kokona, Tiranë, 2006.
 V. Kokona, *Yje të këputur*, Rilindja, Prishtinë, 1986 (me pasthënie nga Hasan Mekuli).

¹² N. Kulla, A. Plasari, *Branko Merxhani – vepra*, Plejad, Tiranë, 2003, f. 18.